

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“DRS site dhe zgjerimi i platformës teknologjike të SCADA”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

32420000-3 - Pajisjet e rrjetit

VLERA E FONDIT LIMIT:

46,400,000 (dyzet e gjashtë milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 460,408.8 (katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e tetë pikë tetë) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 15.04.2024 (1 EUR = 100.78 ALL).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt “DRS site dhe zgjerimi i platformës teknologjike të SCADA”, ka për qëllim të vendosur të realizojë implementimin e infrastrukturës teknologjike të sistemeve të SCADA në site backup me qëllim ruajtjen e informacionit dhe përmirësimin e performancës dhe sigurisë.

Elementet e kësaj procedure prokurimi, janë të ndërlidhura me njëra-tjetren dhe për këtë arsye, kjo procedure nuk mund të ndahet në Lote, pasi krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa Operatore Ekonomik mund të sjellë përdorshmeri të perkohshme ose vonesa të shumta në funksionimin e pajisjeve dhe materialeve të cilat mund të furnizohen nga një tjetër Operator Ekonomik, kontraktor i një loti tjetër.

AK nuk mund të disponojë një element nga mallrat objekt prokurimi në vetë dhe të presë furnizimin e mallrave të tjera, në qoftë se këto janë të ndara në lote.

Gjithashtu, vonesat që mund të shkaktohen nga marrëdhëniet e me disa operatore ekonomike mund të veshtrijojë edhe nevojat e AK për ushtrimin e funksionit të saj.

AK është një institucion i rëndësishëm në sistemin elektro-energjetik shqiptar dhe gjithashtu ben edhe lidhjet e nevojshme me vendet fqinje.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 90,000,000 (nentedhjete milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros te jete ne masën 90,000,000 (nëntëdhjetë milion) Leke.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 18,000,000 (tetembedhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën aferisht 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete aferisht 39 % të vlerës te fondit. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizimin e prodhuesit ose distributorit te autorizuar per te gjithë mallrat objekt prokurimi dhe sherbimet ne lidhje me to. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit te autorizuar duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave, si dhe shërbimeve në lidhje me to. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jodiskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën perkatese të vlefshme ISO, të leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituar nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:*

- ✓ *ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit;*
- ✓ *ISO 27001: për Menaxhimin e sistemit të sigurisë së informacionit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit;*
- ✓ *ISO/IEC 20000-1: për menaxhimin e shërbimeve, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit;*
- ✓ *ISO 22301: për vazhdimësinë e biznesit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Certifikata për menaxhimin e cilësisë ISO 9001: është referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e OE ofertues dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit te sigurise se informacionit ISO 27001: është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht në sistemin elektro-energjetik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur nga Kontraktori. Certifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme AK.

Certifikata për menaxhimin e shërbimeve ISO 20000-1: Ky standard është i nevojshëm për të specifikuar kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit. Ky sistem mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat përbushin kërkesat e dakorduara dhe japin vlerë për konsumatorët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbime. Ky standard u jep kompanive mundësinë të demonstrojnë aftësitë profesionale të tyre në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

Certifikata për vazhdimësinë e biznesit ISO 22301: Nëpërmjet këtij certifikimi, kompania duhet të demonstrojë aftësinë për të konceptuar dhe hartuar plane të parandalimit dhe rikuperimit, për tu përballur me kërcënime të mundshme dhe për të mundësuar vazhdimësinë e shërbimeve të biznesit të OST.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës objekt prokurimi, duhet të ketë punonjësit e nevojshëm prej të paktën 3 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, si më poshtë:*

- ✓ *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL-4 IT Service Management ose ekuivalent.*
- ✓ *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisje “server” ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, në nivelin profesional ose ekspert.*
- ✓ *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisje “storage” ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, në nivelin profesional ose ekspert.*
- ✓ *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për pajisje rrjeti në nivelin profesional ose ekspert.*
- ✓ *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i platformës për virtualizimin e infrastrukturës ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, në nivelin profesional ose ekspert.*

Shenim: *Një punonjës mund të ketë me shumë se një certifikim.*

Per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, per stafin e kerkuar me siper, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: listepagesat e-Sig per periudhen e kerkuar, certifikimet perkatese qe verteton se punonjesi i disponon aftesite profesionale ne perputhje me kerkesat e lartpermendura (te vlefshme), si dhe kontratat e punes.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me stafin e pajisur me certifikata qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale ne perputhje me kerkesat e lartpermendura ekuivalente me te, argumentohet se jane te nevojshem per realizimin e kontrates, konkretisht:

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL-4 IT Service Management ose ekuivalent - Ky kriter shërben për të vërtetuar që operatori ekonomik ka një punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT, eksperiencia e të cilit duhet për të garantuar menaxhimin e duhur të burimeve, mbarëvajtjen e projektit dhe mbylljen e tij brenda afateve të caktuara.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i platformës për pajisje “server” dhe “storage” në nivelin profesional ose ekspert - Ky certifikim është kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik për të realizuar shërbimin dhe për të garantuar implementimin me sukses, për shkak të kritikitetit të zgjidhjes, ngarkesës, mënyrës së konfigurimit dhe informacionit që do të ruhet dhe përpunohet në paisjet që infrastruktura përfshin.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për pajisje rrjeti, ku të paktën njëri të jetë në nivelin profesional ose ekspert - Ky certifikim është kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik për të realizuar shërbimin dhe për të garantuar implementimin me sukses, për shkak të kompleksitetit të zgjidhjes, ngarkesës dhe numrit të të paisjeve të rrjetit që infrastruktura përfshin.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i platformës për virtualizimin e infrastrukturës në nivelin profesional ose ekspert - Ky certifikim është kriter i rëndësishëm për operatorin ekonomik për të realizuar shërbimin e virtualizimit të infrastrukturës dhe implementimin me sukses, për shkak të kritikitetit dhe numrit të makinave virtuale që infrastruktura përfshin.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, si dhe pika 5/c, e nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun e prodhuesit per te gjithë mallrat objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit*

me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të specifikojë se: Mallrat objekt procedure prokurimi janë të reja dhe të pa përdorura me parë.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kerkuar nga AK, është vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 Në funksion të plotesimit të Shtojces 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratores të shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posacem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 datë 08.02.2024, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.